

Permbledhje Joteknike

ID: 1.9 Shpërndarja dhe magazinimi i naftës dhe nënprodukteve të saj: a. magazinimi i naftës dhe nënprodukteve të saj në cisterna të palëvizshme në ndonjë terminal , ose ngarkim /shkarkimi i naftës dhe nënprodukteve të saj në /nga një cisternë e lëvizshme, cisternë hekurudhore, ose anije e ujërave të brendshme në terminal; b. shkarkimi i naftës dhe nënprodukteve të saj në cisternat e stacioneve të furnizimit me karburant..

Emri i Subjektit: “IRA PETROL 2020” SH.A

Administratori: Jani KROJ

Nipt: M04607003F

Adresa qendrore: Korce Bulgarec Dishnice Mbi Rrugen Nacionale Korçë Bilisht, Km. i I,
Objekt privat ne Zonen kadastrale 1491, Nr.pasurie 599/2.

Tabela përmbledhese e permbjedhjes joteknike

1. Profili i operatorit	3
1.1 Proçesi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis	3
1.2 Kerkesat per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis te nje projekti	3
2. Përshkrimi i Instalimit;	5
2.1 Qellimi;	5
2.2 Subjekti investitor;	5
2.3 Vendodhja e ushtrimit te aktivitetit;	5
2.4 Te dhena teknike te aktivitetit;	5
3. Identifikimi dhe vleresimi i shkarkimeve kryesore ne mjedis;	8
4. Identifikimi dhe vleresimi i ndikimeve ne mjedis te aktivitetit;	9
4.1 Analizimi i ndikimeve te pritshme ne mjedis;	10

1. Profili i operatorit

Subjekti “IRA PETROL 2020” do te pajiset me Leje Mjedisit tipi B, sipas legjislacionit aktual ne fuqi, per aktivitetin ID 1.9 Shpërndarja dhe magazinimi i naftës dhe nënprodukteve të saj: a. magazinimi i naftës dhe nënprodukteve të saj në cisterna të palëvizshme në ndonjë terminal , ose ngarkim /shkarkimi i naftës dhe nënprodukteve të saj në /nga një cisternë e lëvizshme, cisternë hekurudhore, ose anije e ujërave të brendshme në terminal; b. shkarkimi i naftës dhe nënprodukteve të saj në cisternat e stacioneve të furnizimit me karburant., i regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit me Nipt M04607003F dhe vendndodhje te ushtrimit te aktivitetit Bulgarec, Dishnice mbi rrugen Nationale Korce-Bilisht, Km 1, objekt privat ne zonen kadastrale 1491, Nr.Pasurie 599/2. Subjekti eshte regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit me date 07.10.2020.

Qellimi i ketij projekti eshte funksionimi i aktivitetit tregetim me shumice i naftes e nenprodukteve te saj. Aktiviteti zhvillohet konform te gjitha rregullave per sa i perket sigurise per instalime te tilla.

Nenshkrimi i nje sere konventash dhe miratimi i kuadrit ligjor per mjedisin ne funksion te tyre, detyron institucionet shtetore dhe subjektet fizike e juridike ti nenshtrohen disa procedurave vleresimi te impaktit te tyre para ndertimit dhe venies ne funksion te aktivitetit, dhe pse aktiviteti ne fjale eshte ekzistues ne te ka operuar me pare nje tjeter kompani per te njejtin funksion.

1.1 Procesi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Studimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) siguron një përmbledhje të të dhënave ekzistuese dhe informacion mbi kushtet e zhvillimit te aktivitetit. Në procesin studimor të VNM përdoret informacioni dhe të dhënat teknike ekzistuese. Vleresimi i ndikimit ne mjedis hartohet qe ne fazen e project idese per zhvillimin e aktivitetit, por gjithsesi edhe per aktivite te ekzistuese te cilat jane objekt i nje leje mjedisore ose i ligjit per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis. Sipas kushtetutes se Republikes se Shqiperise, shteti siguron me te gjitha mjetet dhe mundesite qe ka, nje mjedis te paster dhe te sigurte per qytetaret dhe brezat e ardhshem.

1.2 Kërkesat Vlerësimin te Ndikimit në mjedis të një projekti

Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejta mjedisore të zbatimit apo moszbatimit të projektit.

Ndikimet mjedisore të projektit vlerësohen në lidhje me gjendjen e mjedisit në territorin e prekur në kohën e paraqitjes së raportit përkatës për vlerësimin e ndikimit në mjedis të projektit. Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përgatitjen, zbatimin, funksionimin dhe mbylljen e tij, sipas rastit, edhe pasojat e mbylljes së veprimtarisë, dhe dekontaminimin/pastrimin apo rikthimin e zonës në gjendjen e mëparshme, nëse një detyrim i tillë parashikohet me ligj. Vlerësimi përfshin, sipas rastit, si funksionimin normal, ashtu edhe mundësinë për aksidente.

Vlerësimi i projektit përfshin, gjithashtu, propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve të tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjatë zbatimit të projektit, përfshirë edhe vlerësimin e efekteve të pritshme të masave të propozuara.

Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, të ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse nga autoriteti përgjegjës për zhvillimin ose jo të projektit.

Procedura e vlerëimit të ndikimit në mjedis përfshin:

- a) procesin paraprak të vlerëimit të ndikimit në mjedis;
- b) procesin e thelluar të vlerëimit të ndikimit në mjedis.

Dokumenti bazë ku mbështetet procesi i VNM-së, është raporti i vlerëimit të ndikimit në mjedis, i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit, mund të jetë:

- a) raporti paraprak i VNM-së për projektet e shtojcës II;
- b) raporti i thelluar i VNM-së për projektet e shtojcës I.

2. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

2.1 Qellimi i aktivitetit

Qellimi i funksionimit të këtij aktiviteti është “Depozita Karburantesh”, tregëtim me shumicë të naftës dhe nënprodukteve të saj, duke marrë parasysh të gjitha dispozitat ligjore në fuqi, gjithashtu duke minimizuar në mënyrë të mirë ndikimet në mjedis që mund të lindin nga zhvillimi i këtij aktiviteti. Gjithashtu edhe mirefunksionimi dhe ruajtja e sigurisë për aktivitetin në fjalë.

Në këtë raport do të vlerësojmë vetëm ndikimet e funksionimit të këtij aktiviteti.

2.2 Subjekti investitor

Operatori “IRA PETROL” SH.A do të ushtrojë aktivitetin “Depozita Karburantesh”, tregëtim me shumicë të naftës dhe nënprodukteve të saj.

2.3 Vendodhja e aktivitetit

Adresa qendrore e aktivitetit është Korçë, Bulgarec, Dishnice mbi rrugën Nacionale Korçë-Bilishtë, km.1, objekt private në Zonën Kadastarë 1491, Nr.Pasurie 599/2.

2.4 Te dhena teknike te aktivitetit

Pershkrimi i aktivitetit.

Aktiviteti i operatorit "IRA PETROL" SH.A zhvillohet ne nje siperfaqe prej 20541 m². Ne kete park do te depozitohen me qellim ruajtjen dhe shperndarjen e dy produkteve benzol dhe gasoline. Hidrokarburet e lengshme perfshire ketu edhe benzolin e gaszoilin, ose si quhen ne gjuhen e perditshme karburantet, jane te ndjeshme ndaj burimeve te nxehtesise. Ato jane te aft ate ndizen po edhe te shkaktojne zjarr dhe eksplozion. Jane avuj dhe gazet mbi sipefaqen e lengut qe reagojne ne kete menyre.

Hidrokarburet e lengshme perfshihen ne kategorine e I-re dhe te II-te, pika e flakerimit e te cilave eshte deri ne 100 °C.

Rezervuaret e bezolit dhe gazoilit

Duke patur parasysh rrezikshmerine qe paraqesin hidrokarburet e lengshme, ruajtja e tyre behet ne rezervuar te mbyllur, cka jep shume garanci per te zvogeluar ne kete menyre deri ne shmangie te plote rrezikshmerine.

Ne kete aktivitet me objekt Depozita Karburantesh, "Tregetim me shumice i naftes dhe nenprodukteve te saj" ruhen ne rezervuare, te specifikuar si me poshte:

Per gazoilin rezervuare 1 X 2400 m³

4 X 100 m³ dhe 4 X 40 m³

Ndersa benzoli 2 X 100 m³

Rezervuaret sipas kapacitetit mbajtes jane me dimensione te ndryshme: 18000 X 15000 mm, 2500 X 6400 mm dhe 1500 X 3400 mm. ata jane metalik, te tipit siperfaqesore, vertikal dhe horizontal. Keta lloj rezervuaresh kane avantazhe dhe jane me te perdorshmit.

Per ndertimin e rezervuarve ka norma te vecanta te cilat percaktojne kerkesat ndaj bazamentit, trashesine e metalit, menyren e saldimit dhe llojin e tegelit si dhe paisjet qe duhet te kete rezervuari per nje funksionim normal, te sigurte dhe afat gjate.

Cdo rezervuare aktualisht ka keto paisje:

- tubacionin e hyrjes dhe te daljes se karburantit;
- paisjet dhe vendin per marrjen e karburantit;
- paisjet per shakrkimin e ujit e te papastertive te tjera;
- valvulat e ajrimit (hidraulike dhe mekanike);
- nivel matesin;
- tokezimin;
- flakeshuarsen;
- mbrojtje atmosferike (sipas normave te vecanta);
- tubacionet e sistemit automatike te shuarjes se zjarrit dhe te ftohjes se siperfaqes (sipas normave, kjo vetem per rezervuarin me kapacitet 2400 m³);

Ne objekt jane me shume se 12 rezervuar, pervec rezervuarve kemi edhe objekte te tjera ne perberje te skemes teknologjike si: stacioni shkarkimit dhe ai i mbushjes se autocisternave, stacionet respektive te pompimit, godina e zyrave, vendrojet, rruget e brendhme etj. Per keto arsye objekti eshte i standartit park rezervuaresh.

Bazuar ne numrin e rezervuarve, madhesine tyre, llojin e karburanteve etj, territori ku ngrihet parku i rezervuarve, planimetria e vendosjes se elementeve perberes brenda parkut, largesite midis ketyre elementeve etj. Te gjitha keto jane te percaktuara ne normat perkatese dhe duhet te jene ne perputhje me kerkesat normative te "Kodit te hidrokarbureve".

Parqet e rezervuarve rrethohen me gardh i cili duhet te kete lartesi jo me te vogel se 2.5 m. Preferohet te jete me sistem ndricimi dhe alarmi. Mire eshte te kete ndertim te tille qe te kete ajrosje, per te mos lejuar perqendrimin e avujve dhe gazeve te djegshme. Aktualisht parku i rezervuarve eshte i rrethuar ne te gjitha perimetrin e tij eshte i siguruar me roje dhe i ndricuar.

Rezervualet te vecante ose ne grup vendosen brenda nje argjinature mbajtese qe te mosderdhen aksidentalisht nga rezervuari. Per kete qelli argjinaturat duhet:

- Te mbajne brenda rrethimit sasine e planifikuar te hidrokarburit;
- Te mos lejoje filtrime te produktit te derdhur;
- Te mos lejoje perhapjen e zjarrit;
- Te duroje jo me pak se 4 ore ne kushte zjarri;
- Te jete e qendrueshme ne kushtet e nje zjarri;

Argjinaturat mund te ndertohen me ledhe dheu ose prej betoni. Ne aktivitet jane 2 grupe argjinaturash, rezervuari i gazoilut me kapacitet mbajtes 2400 m³ ka argjinature te vecante, realizuar me mure betoni, me lartesi 2.8 m dhe me kapacitet mbajtes 1200 m³, rezervualet me kapacitet 100 m secili kane argjinature ne grup, realizuar po me mure betoni, me lartesi 2.5 m dhe me kapacitet mbajtes 340 m³. Keto argjinaturajane ne konformitet me kerkesat normative.

Brenda parkut duhet te kete dhe rruge me gjeresi jo me te vogel se 3.5 m. ne menyre te tille qe automjetet zjarrfikse te afrohen jo me larg se 30 m nga rezervuari me i larget dhe te kete vend per manovrimin dhe kthimin e mjeteve ne rast te renies se zjarrit. Gjithashtu edhe rruget e jashtme duhet te jene te standartit per te lejuar kalimin dhe afrimin e cdo lloji mjete ne raste emergjente.

3. Identifikimi dhe Vleresimit i shkarkimeve ne mjedis

Mjedisi eshte gjithmone i prekur nga veprimtarite e ndryshme qe ushtrohen ne te, por ndikimi mund te jete i ndryshem, kjo eshte e lidhur ngushte me vete llojin e veprimtarise e cila mund te kete impakt te drejtperdrejte, te terthorte, te rendesishem apo mesatar i pranueshem.

Nga zhvillimi i aktivitetit pritet qe te kete shkarkime minimale ne mjedis, duke iu referuar edhe natyres se tij.

Zhvillimi i ketij aktiviteti mund te sjelle ndikime negative ne mjedis si :

- Rrjedhje te pa kontrolluara te karburanteve gjate furnizimit te depozitave dhe te autoboteve.
- Shkarkim i karburanteve bashke me ujerat larese apo ujerat e shiut.
- Renia e zjarreve.

4. Identifikimi dhe vleresimi i ndikimeve ne mjedis te aktivitetit

Vleresimi i ndikimeve ne mjedis kryhet duke u bazuar mbi parimet e mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes së integruar
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
- Parimi “Ndotësi paguan”
- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Ky vleresim kryhet ne baze te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 “Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” dhe VKM Nr. 13, date 04.01.2013 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis” dhe ka si synim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi. Kjo përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë:

- a) Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
- b) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- c) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- d) Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;

4.1 Ndikimet e pritshme ne mjedis nga zhvillimi i aktivitetit

Ndikimet e mundshme gjate fazes se funksionimit te aktivitetit mund te permblihen sipas elementeve te mjedisit, si me poshte:

Ndikime ne toke	
OPERACIONI	PASOJA NË MJEDIS
Instalimi	Aktiviteti ne fjale eshte I ndertuar dhe ne funksion pasi eshte perdorur me pare nfa nje tjetere operator.
Lëvizja e automjeteve të transportit	<p>Si pasojë e lëvizjes së makinerive:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mund të kemi rrjedhje aksidentale të lubrifikantëve nga ndonjë avari me pasojë ndotje të tokës. - Mund të kemi rendim të trafikut rrugor. <p>Ne raste të tilla do të pastrohet në mënyrë të menjehershme zona, ndërsa në rastet e trafikut operatori operon në përputhje me kondicionet urbane. Theksojmë faktin se zona është urbane dhe shpeshherë me trafik të rënduar. Mbushja e depozitës nga autobotet do të kryhet në orare ku shmanget trafiku rrugor.</p>
Magazininim i lëndës së parë hidrokarbure/karburante	<p>Si rezultat mund të kemi emergjencë të ndryshme, zjarre etj.</p> <p>Operatori kryen teste të papershkrueshmërisë për pajisje nën presion nga subjekte të licencuara çdo 1 vit.</p>

Ndikime ne uje	
OPERACIONI	PASOJA NË MJEDIS
Instalimi	<p>Shkarkimet ne ujera vijne nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ujerat e ndotur higjenosanitare te ambientit te stafit. <p>Kjo tipologji ndikimi eshte normal. Gjithashtu operatori perdor detergjente me permbajtje te ulet kimikatesh per te ruajtur cilsine e mjedisit ujeor prites.</p>

Ndikime ne biodiversitet	
OPERACIONI	PASOJA NË MJEDIS
Instalimi	Funksionimi i aktivitetit mund të shoqërohet me modifikim të pejsazhit ekzistues.

Për të minimizuar këtë ndikim, operatori do të mbjelle fidane ne perimetrin rrethues te jashtem dhe te brendshem.

Ndikime ne ajer

OPERACIONI	PASOJA NË MJEDIS
Instalimi	<p>Si pasojë e lëvizjes së automjeteve do të gjenerohen:</p> <ul style="list-style-type: none">- zhurma,- pluhur,- gaze nga djegia e motoreve me djegie te brendshme. <p>Per keto ndikimi te analizuara operatori ka marre masa te ndryshme duke mos lejuar renien e burise ne ambjetet e furnzimit, duke shtruar me beton sheshin ne shfrytezim dhe duke detyruar mjetet per fikjen e tyre gjate momentit te furnzimit.</p>

PER “IRA PETROL” SH.A

ADMINISTRATOR

Jani KROJ